

VENDIM
Nr. 661, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I
KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/3. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 111 821 603 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku